



ATU

ALBANIAN TELECOMMUNICATIONS UNION

meeting
the future

rreth nesh

Meeting the future


E themeluar në Shtator 2010, kompania Albanian Telecommunications Union (ATU) është në përfundim të ndërtimit të rrjetit të saj të fibrave optike, 750 km të gjatë, në rrugët kombëtare të Shqipërisë, duke operuar nëpërmjet liçencës së dhënë nga Autoritetet Qeveritare Shqiptare.

Biznesi kryesor i kompanisë është ofrimi i kapaciteteve me shumicë për shërbime të dhënash dhe internet, brenda Shqipërisë, si dhe për tranzit ndërkombëtar. Ndërlidhja me të gjitha qytetet kryesore të vendit, si dhe me kufijtë me të gjitha shtetet fqinje, mundëson që ATU t'i ofrojë shërbime tregut vendas dhe atij ndërkombëtar, duke menaxhuar volumin në rritje të trafikut të telekomunikacioneve nga dhe drejt Shqipërisë.

Nëpërmjet rrjetit të fibrave optike, teknologjisë së transmetimit DWDM dhe një personeli të kualifikuar dhe të trajnuar, synojmë të përmbushim të gjitha kërkesat e mundshme të klientëve tanë, njëkohësisht për komunikim midis qyteteve kryesore të Shqipërisë dhe destinacioneve ndërkombëtare, me ndërmjetësimin e partnerëve që kanë prezencë globale.

Aplikimi i risive teknologjike në ndërtimin, funksionimin dhe shtrirjen e rrjetit tonë, mundëson një nivel të lartë dhe një gamë të gjerë shërbimesh. Kompania ka një strukturë dinamike, të fokusuar dhe të orientuar ndaj klientëve vendas dhe të huaj, duke garantuar shërbime cilësore dhe çmime konkurruese.

ATU po themelon një epokë të re në transmetimin kombëtar dhe ndërkombëtar të të dhënave për tregun shqiptar. Kemi një mision të qartë për të pozicionuar Shqipërinë në qendrën e Teknologjisë së Informacionit dhe Telekomunikacioneve në rajon.



përsosmëri operacionale

Rrjeti ATU

Rrjeti ynë lidh 20 qytete kryesore të Shqipërisë dhe ofron kapacitete tranziti ndërkombëtar, në çdo pikë kufitare me të gjitha shtetet fqinje. Përkatësisht: Kosova (Morinë), Maqedonia (Qafë Thanë dhe Tushemisht) Mali i Zi (Murriqan dhe Hani i Hotit) dhe Greqia (Kakavijë dhe Kapshticë).

Harta e rrjetit, në faqen vijuese, tregon vijat e ndërtimit dhe Pikat e Prezencës (PoP), të cilat janë instaluar në të gjitha qytetet kryesore të Shqipërisë. Çdo Pikë Prezence (PoP) do të shërbejë si një mini qendër për ruajtjen e të dhënave (mini data center) për të strehuar pajisjet e telekomunikacionit dhe pajisjet kryesore të infrastrukturës së IT-së së ATU-së dhe klientëve të saj, duke bërë të mundur në këtë mënyrë që çdo klient të krijojë një mini PoP për të shpërndarë shërbim në çdo qytet të vendit ku ka interes.

Shtirja e rrjetit të fibrave kryhet nëpërmjet përdorimit të metodës së mini gërmimit për ndërtimin e infrastrukturës dhe metodës së fryrjes për shtirjen e kabllit optik.



Qendra e Operimit të Rrjetit (NOC)


ATU zotëron një rrjet të gjerë fibrash optike të cilat lehtësojnë komunikimin e të dhënave në territorin shqiptar. Për të ofruar te klientët tanë shërbime sa më efikase dhe cilësore, kemi lidhur marrëveshje të forta bashkëpunimi me një sërë partnerësh, OFS për kabllimin e fibrës optike, Huawei për teknologjinë DWDM të transmetimit dhe Cisco për administrimin dhe shpërndarjen e Internetit të Dedikuar (IP).

Përdorimi i Sistemit të Menaxhimit të Rrjetit ofron siguri për identifikimin e menjëhershëm të defekteve dhe vlerësimin e tyre në kohë të shkurtër. Ndjekja e procedurave rigoroze të menaxhimit të defekteve, zbatimi i shpejtë dhe efikas i masave parandaluese dhe riparuese, në rastet kur ndodh një defekt në funksionimin e shërbimit është një tjetër përparësi në drejtim të cilësisë.

Aktiviteti operacional i rrjetit të fibrës optike vëzhgohet dhe administrohet nga qendra jonë e operimit të rrjetit, e cila ndodhet në Kashar, Tiranë.

Për të siguruar performancë optimale, vëmendje dhe përgjigje të menjëhershme për çdo problem që lidhet me shërbimin apo rrjetin, stafi i kualifikuar i kujdesit ndaj klientit operon 24/7.

Rrjeti ATU



Statistika Rrjeti

- ▶ 750 km rrjet me fibër optike.
- ▶ Pika Prezence në 12 qytete dhe pajisje aktive respektive. Përkatësisht: Tiranë (Kashar), Durrës, Elbasan, Pogradec, Korçë, Shkodër, Repe, Kukës, Fier, Vlorë, Tepelenë dhe Gjirokastër.
- ▶ 20 qytete me mundësi për lidhje direkte në rrjet. Përkatësisht: Tiranë, Durrës, Kavajë, Rrogozhinë, Peqin, Elbasan, Librazhd, Pogradec, Korçë, Krujë, Laç, Lezhë, Shkodër, Mirditë, Kukës, Lushnje, Fier, Vlorë, Tepelenë dhe Gjirokastër.
- ▶ Ndërlidhje me 4 shtete fqinje: Përkatësisht: Mali i Zi, Kosovë, Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë dhe Greqi.

ju lidhim me botën

Produktet ATU

Ofrojmë për klientët tanë një sërë shërbimesh bazuar në rrjetin tonë inovativ në përputhje me marrëveshjet e mëposhtme tregtare:

Linja me qera nga një pikë në tjetrën

ATU, nëpërmjet rrjetit të transmetimit bazuar në teknologjinë DWDM, ofron linja transparente me qera në protokollin e tyre amëtar. Ky protokoll përfshin SDH dhe Ethernet. Çdo linjë me qera ofrohet nga një pikë në tjetrën. Në këtë mënyrë, klientët tanë mund të kenë një lidhje të sigurt duke ditur se të dhënat e tyre do të transportohen pa patur nevojë të bëjnë konvertim të protokollit.

Akses i dedikuar Interneti - Shërbime Tranzit IP

Cilësia e një shërbimi IP është po aq e mirë sa rrjeti në të cilin kalon. Më në fund, me rrjetin më inovativ të Shqipërisë, vendi mund të ketë internetin që meriton, në cilësinë më të lartë të disponueshme dhe me çmime konkurruese. Ofruesit e shërbimit të internetit kanë mundësinë të sigurojnë kapacitete interneti për të kënaqur me të vërtetë klientët e tyre.

Fibër e dedikuar (Dark Fiber) bazuar në marrëveshje IRU

Shërbimet e Fibrës së Errët të ATU-së janë projektuar për të vendosur klientët në kontroll të plotë të rrjetit të tyre. Fibra e errët ofron fleksibilitet zgjedhjeje mbi platformat e shërbimeve që një klient mund të dëshirojë të implementojë. Klientët tanë janë të sigurt duke ditur se zgjerimi dhe kontrolli i plotë janë të garantuar në duart e tyre.

Kapacitetet bazuar në marrëveshje IRU

Si një operator bartës me shumicë, ATU mund të ofrojë gjithashtu forma të tjera fleksibiliteti për klientët e saj. Një nga këto është kapaciteti total i cili lejon klientët që operojnë në një mjedis dinamik tregu, të menaxhojnë dhe rregullojnë gjerësinë e brezit të tyre në çdo pjesë të rrjetit.



Linja afatgjata me qera nga një pikë në tjetrën

Shërbimi i linjave afatgjata me qera nga një pikë në tjetrën është një tjetër alternativë për klientët që e njohin plan-biznesin e tyre afatgjatë dhe mund të kenë kapacitetet e kërkuara për periudhën e kohës që do të plotësojë nevojat e parashikuara. Duke ofruar këtë shërbim, klientët tanë nuk kanë pse të shpenzojnë kohë duke kërkuar që kapacitetet të rregullohen vazhdimisht bashkë me faturat respektive. Kjo kohë mund të shfrytëzohet për çështje më të rëndësishme të biznesit.

Të gjitha shërbimet transmetohen nëpërmjet teknologjisë DWDM (Dense Wavelength Division Multiplexing) duke mundësuar transportin e të dhënave me kapacitete shumë të larta.

Shërbimet e lartpërmendura përfshijnë kapacitete që varrojnë nga STM-1/4/16/64 në teknologjinë SDH, dhe nga 10Mbps /100Mbps /1000Mbps /10 Gbps në teknologjinë Ethernet, sipas kërkesave të klientit.

www.atu.al



ATU

ALBANIAN TELECOMMUNICATIONS UNION

Zyrat Qëndrore

ABA Business Center
Kati nr. 14 / Zyra nr. 7
Tiranë, Shqipëri
Tel: +355 4 2400810
Fax: +355 4 2400811
Email: info@atu.al

Qendra e Operimit të Rrjetit (NOC)

Rruga Dytësore Tiranë - Vorë
pranë mbikalimit të aeroportit "Nënë Tereza"
Kashar, Tiranë, Shqipëri
Tel: +355 4 2408061
Email: noc@atu.al